



Tiranë më, 09.10.2020

Drejtuar: Portalit Reporter.al

Lënda: Reagim

Përpara disa ditësh jemi njohur me artikullin me titull: *“Milionat për pastrimin e lumenjve nga mbetjet e mori lumi”* me autor z. Besmir Likmeta, publikuar në faqen tuaj online në dt 5 Tetor 2020. Disa nga komentet i vlerësojmë jo korrekte e për rrjedhim në dëm të imazhit të shoqërisë “Integrated Technology Services” Sh.p.k.

Në një paragraf të artikullit shkruhet: *“Një vit më vonë, barriera e ndërtuar nga kompania “Integrated Technology Services”, ITS Sh.p.k –kompania kontroverse që dominon sektorin e trajtimit të mbetjeve nëpërmjet kontratave koncesionare, u shkatërrua nga rrjedha e lumit Shkumbin”*. Ju bëjmë me dije se nuk ka një lidhje mes shkatërrimit të barrierës dhe ndërtimit të saj nga shoqëria jonë. Shoqëria është kontraktuar për ndërtimin e këtij objekti, i cili kishte një garanci 12 mujore. Objekti nga ana e sipërmarrësit i është dorëzuar Autoritetit Kontraktues më datë 01/09/2016, ky i fundit më pas i ka bërë dorëzimin Bashkise dhe garancia e objektit ka përfunduar më datë 31/08/2017. Ndaj, në kohën kur ky objekt ka dalë jashtë funksionit, në rast se ky fakt është i vërtetë, theksojmë që nuk ka qenë përgjegjësi e shoqërisë tonë mirëmbajtja dhe ruajtja e tij, por e autoritetit vendor të cilit i është dorëzuar. Gjithashtu pretendimin e ngritur në artikullin tuaj mbi padobishmërinë e këtij projekti e vlerësojmë si të pasaktë për sa na jeni referuar. Konkretisht po citojmë atë që është shkruar në artikull: *“Ekspertët theksojnë, se projekte të tilla nuk kontribuojnë në ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të mbetjeve dhe si rrjedhojë kanë një ndikim të limituar kundër ndotjes së lumenjve dhe detit.” Ajo që i mungon realisht Shqipërisë, përveç problemeve të tjera, është mungesa e një sistemi menaxhimi mbetjesh të ngurta – kapilar dhe efektiv”, tha Olsi Nika, drejtor ekzekutiv i organizatës mjedisore Eco Albania”*.

Theksojmë, se ky projekt nuk ka patur si qëllim ngritjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit në vend, por të ndikonte në pastrimin e lumenjve të Shqipërisë nga mbetjet e ngurta. Duam të sqarojmë ju dhe lexuesin, se projekti është një projekt pilot, pra në bazë të ecures së tij do të përcaktohej nëse ky sistem pastrimi i lumenjve nga mbetjet e ngurta do të aplikohet në një rang më të gjerë.

Më tej në artikullin tuaj shkruhet se: *“Ata theksojnë që ky lloj impianti në rastin më të mirë kap makroplastikat, ndërkohë që nuk adreson ndotjen e lumenjve nga mikroplastika dhe substancat kimike. “Ajo që shohim ne me plastikën është ndotja nga makroplastika, e cila është përgjithësisht ndotje pamore, sepse plastika do shumë kohë të shpërbëhet, të dekompozohet dhe të çlirojë komponentët e vet kimikë në ujë”*

Sqarojmë për sa na takon, se ky projekt ka patur për objektiv kapjen e mbetjeve të ngurta, ku përfshihet edhe plastika (makroplastika) e cila, referuar shumë studimeve të BE dhe instituteve kërkimore ndërkombëtare, është një nga burimet kryesore të mikroplastkës dhe ndotjes kimike të ujërave. E respektojmë mendimin e ekspertëve, por në rastin e këtij artikulli është keqpërdorur objektivi i projektit dhe të dhënat mbi shoqërinë tonë.

Në artikullin tuaj thuhet ndër të tjera se; *“Të kontaktuara nga BIRN, Ministria e Mjedisit dhe kompania “Integrated Technology Services” nuk iu përgjigjën një kërkesë për koment”*. Në postën elektronike të kompanisë kërkesa për informacion ka ardhur në 1 Tetor në orën 17: 28 pra ditën e Enjte dhe të Hënën paradite shkrimi është publikuar pa pritur përgjigjet zyrtare nga kompania. Sqarojmë se për një projekt, i cili ka 4 vjet që ka përfunduar hulumtimi i përket arkivit dhe një ditë kohë pra dita e nesërme, është një kohë e kufizuar për të bërë një raport shterues mbi pyetjet tuaja.

Për të gjitha sa shpjeguem më sipër kërkojmë rishikimin e shkrimit dhe saktësimin e komentit mbi këtë projekt.

**“Integrated Technology Services” shpk**

**Administratori**

**Denisa Tollkuçi**

  
